



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 185

22 nëntor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 161/2013 datë 17.10.2013	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 30.9.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” 7807
Vendim i Kuvendit nr. 61/2013 datë 14.11.2013	Për rrëzimin e dekretit nr. 8383, datë 8.11.2013, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 161/2013, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 30.9.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” 7807
Vendim i Kuvendit nr. 62/2013 datë 14.11.2013	Për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve dhe konstatimin e vlefshmërisë dhe ligjshmërisë së zgjedhjes së anëtarëve dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP-it..... 7808
Dekret nr. 8389 datë 13.11.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7808
Vendim i KM nr. 993, datë 8.11.2013	Për transferimin e objektit me emërtimin “Dampa e hirave-TEC”, pjesë përbërëse e pronës “Kombinati Energjetik sh.a., Elbasan”, në pronësi të bashkisë Elbasan të qarkut të Elbasanit 7809
Vendim i KM nr. 994, datë 8.11.2013	Për shfuqizimin e vendimit nr. 658, datë 7.8.2013 të Këshillit të Ministrave, dhe ripërtëritjen e fuqisë ligjore të disa pikave të vendimit nr. 771, datë 7.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kritereve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat spitalore universitare” 7812

Vendim i KM nr. 995, datë 8.11.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për dhënie ndihme financiare familjes së të ndjerit Lirak Bejko, ish-i dënuar politik, i vetëflijuar gjatë grevës së urisë në nëntor 2012.....	7812
Vendim i KM nr. 997, datë 8.11.2013	Për lejimin e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë, për vazhdimin e kryerjes së procedurës së prokurimit publik për shërbimin me roje civile.....	7813
Vendim i KM nr. 1001, datë 13.11.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 280, datë 15.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse”.....	7813
Vendim i KM nr. 1002, datë 13.11.2013	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.....	7814
Vendim i KM nr. 1003, datë 13.11.2013	Për shfuqizimin e vendimit nr. 983, datë 10.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kompetencave të Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” dhe riorganizimin e disa institucioneve të trashëgimisë kulturore”...	7815
Vendim i KM nr. 1007, datë 13.11.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 332, datë 17.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile”, të ndryshuar.....	7815
Vendim i KM nr. 1008, datë 13.11.2013	Për lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes për zhvillimin e procedurës së prokurimit, me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të vëzhgimit të integruar të hapësirës detare”.....	7818

LIGJ
Nr. 161/2013

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 5, DATË 30.9.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 152/2013
“PËR NËPUNËSIN CIVIL””**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “e”, dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 30.9.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil””.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 17.10.2013

VENDIM
Nr. 61/2013

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 8383, DATË 8.11.2013, TË PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR. 161/2013, “PËR
MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 5, DATË 30.9.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 152/2013,
“PËR NËPUNËSIN CIVIL””**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 8383, datë 8.11.2013, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 161/2013, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 30.9.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 14.11.2013



VENDIM
Nr. 62/2013

**PËR KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË ABSOLUTE TË VENDIMEVE DHE
KONSTATIMIN E VLEFSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË SË ZGJEDHJES SË
ANËTARËVE DHE KRYETARIT TË KËSHILLIT DREJTUES TË AKEP-IT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 105 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurës Administrative”, të neneve 114 dhe 116 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave, bazuar në shqyrtimin në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe në raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve nr. 28/2013, 29/2013, 30/2013, 31/2013 dhe 32/2013 për lirim të anëtarëve dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP-it.

II. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve nr. 33/2013, 34/2013, 35/2013, 36/2013, 37/2013 dhe 38/2013 për zgjedhjen e anëtarëve dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP-it.

III. Konfirmimin e vlefshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimeve nr. 14, 15, 16, 17 e 19, datë 26.11.2009, dhe nr. 130, datë 13.10.2011, për zgjedhjen e anëtarëve dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP-it dhe vazhdimësinë e ushtrimit të mandatit të mbetur 5-vjeçar.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 14.11.2013

DEKRET
Nr. 8389, datë 13.11.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------|--|
| 1. Christian Staoros Canacaris | 14. Ildir Spiro Peçi |
| 2. Valbona Xhevdet Petrovci | 15. Kosovare Bajram Kelmendi Dautaj |
| 3. Astrit Enver Petrovci | 16. Fadil Ragip Dautaj |
| 4. Vanesa Enver Petrovci | 17. Anita Fadil Dautaj |
| 5. Hana Enver Petrovci Fetahu | 18. Anyla Fadil Dautaj |
| 6. Valon Qerim Fetahu | 19. Vjollca Bedrudin Kelmendi (Bekteshi) |
| 7. Nol Valon Fetahu | 20. Sokol Kastriot Kelmendi |
| 8. Hydajet Ramiz Hyseni Kaloshi | 21. Elena Kastriot Kelmendi |
| 9. Berat Selman Luzha | 22. Alvin Fran Karaqi |
| 10. Gani Selman Krasniqi | 23. Orges Fadil Arifi |
| 11. Selahudin Ismail Novosella | 24. Sabit Shefqet Dallku |
| 12. Basri Faik Musmurati | 25. Nerxhivane Bejtulla Dallku |
| 13. Teuta Izet Hadri | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 993, datë 8.11.2013

PËR TRANSFERIMIN E OBJEKTIT ME EMËRTIMIN “DAMPA E HIRAVE-TEC”, PJESË PËRBËRËSE E PRONËS “KOMBINATI ENERGJETIK SHA, ELBASAN”, NË PRONËSI TË BASHKISË ELBASAN TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “e”, 5, 6, 7, 8 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme e të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti me emërtimin “Dampa e hirave-TEC”, pjesë përbërëse e pronës “Kombinati Energjetik sh.a. Elbasan”, të kalojë në pronësi të bashkisë Elbasan të qarkut të Elbasanit, për trajtimin e mbetjeve urbane, sipas planvendosjes dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Bashkisë Elbasan i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Objekti i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e komponentëve përbërës të pronës “Kombinati Energjetik sh.a., Elbasan”.


4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, kryetari i bashkisë Elbasan dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANVENDOSJE E DAMPES T.E.C.KOMBINATI METALURGJIK ELBASAN

SHKALLA-1-10000



TE DHENA TEKNIKE	
DAMPA E FAZES PARE NR-1	DAMPA E FAZES DYTE NR-2
GUATESIA 920 MLGJERESIA 85-162 ML	GUATESIA~1087 ML
THELESIA 8ML	THELESIA 5-8ML
SUPERFAQJA~117500 m2	SUPERFAQJA~179000 m2
VOLUMI 940000 m3	VOLUMI 1360000 m3

BASKIA ELBASAN		DIREKTORIA E PROJEKTEVE E STANDARTIZIME	
VP/PA	SHKURTYZIMET E NIVELIMIT	DIREKTORI	SHKURTYZIMET E NIVELIMIT
EMERTIMI		PROJEKTORES	
POSITIMI	BASKIA ELBASAN		
INVESTITORI	BASKIA ELBASAN		
			TOPOGRAFI

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia : Elbasan										
Fusha e perdorimit te Prones: Depozitim dhe Perpunimi i Mbetjeve Urbane										
A				B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhëna tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
960	E 2124 Katundi i Ri EL 8526 Elbasan			ish DAMP-a e TEC-it (ish K Metalurgjik)	440268		per depozitim dhe perpunimin e mbetjeve urbane	Bashkia Elbasan	Bashkia Elbasan	Nr kadastrale (nr pasurive) 144/13, 144/14, 144/15, 405, 144/16 600/1, 600/6, 600/2, 600/5, 600/7, 600/3 Pjese pa numer me sip. 11151 m2 407/3, 407/4, 407/7, 407/8, 407/2, 407/8/3, 407/5, 407/6/1, 406/8/1 405/11



VENDIM

Nr. 994, datë 8.11.2013

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 658, DATË 7.8.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, DHE RIPËRTËRITJEN E FUQISË LIGJORE TË DISA PIKAVE TË
VENDIMIT NR. 771, DATË 7.11.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT DHE
KAPACITETEVE TË NJËSISË SË SHËRBIMIT NË QENDRAT SPITALORE
UNIVERSITARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 123, 125 e 127 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 658, datë 7.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat spitalore universitare”.

2. Ripërtëritjen e fuqisë ligjore të pikave 1, 2 dhe 3 të vendimit nr. 771, datë 7.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat spitalore universitare”.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë të ndjekë procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 995, datë 8.11.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE
FAMILJES SË TË NDJERIT LIRAK BEJKO, ISH-I DËNUAR POLITIK, I VETËFLIJUAR
GJATË GREVËS SË URISË NË NËNTOR 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në buxhetin e vitit 2013, t’i shtohet fondi prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, për dhënien e ndihmës financiare familjes së të ndjerit Lirak Bejko, ish-i dënuar politik, i vetëfljuar gjatë grevës së urisë në nëntor 2012.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 997, datë 8.11.2013

**PËR LEJIMIN E MUZEUT KOMBËTAR TË ARTIT MESJETAR, KORÇË, PËR
VAZHDIMIN E KRYERJES SË PROCEDURËS SË PROKURIMIT PUBLIK PËR
SHËRBBIMIN ME ROJE CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimin nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë, të vazhdojë kryerjen e procedurës së prokurimit publik, me fond limit 387 000 (treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë, pa TVSH, për shërbimin me roje civile, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1001, datë 13.11.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 280, DATË 15.1.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RUAJTJEN, MIRËMBAJTJEN DHE DHËNIEN ME QIRA TË
OBJEKTEVE FORTIFIKUESE E MBROJTËSE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 280, datë 15.1.1996 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:



“5. Marrësit në ruajtje do të lidhin kontratë qiraje për çdo periudhë që do të përdorin objektet fortifikuese.”.

b) Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. Lidhja e kontratës së qirasë për këto objekte të bëhet sipas legjislacionit në fuqi për dhënien me qira të pasurisë shtetërore.”.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 1002, datë 13.11.2013

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve buxhetore në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Forcat e luftimit”, zëri “Shpenzime korente”, të pakësohet fondi 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë;

b) Në programin “Arsimimi ushtarak”, zëri “Shpenzime korente”, të pakësohet fondi 42 500 000 (dyzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekë;

c) Në programin “Bashkëpunimi civilo-ushtarak”, zëri “Shpenzime korente”, të pakësohet fondi 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë;

ç) Në programin “Mbështetja e luftimit”, zëri “Shpenzime korente”, të shtohet fondi 63 500 000 (gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind mijë) lekë.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM
Nr. 1003, datë 13.11.2013

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 983, DATË 10.11.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KOMPETENCAVE TË INSTITUTIT TË
MONUMENTEVE TË KULTURËS “GANI STRAZIMIRI” DHE RIORGANIZIMIN E DISA
INSTITUCIONEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 983, datë 10.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kompetencave të Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” dhe riorganizimin e disa institucioneve të trashëgimisë kulturore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1007, datë 13.11.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 332, DATË 17.3.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, ELEMENTEVE PËRBËRËSE,
MËNYRËS SË MBAJTJES E AFATIT TË PËRDORIMIT TË DOKUMENTEVE BAZË, QË
MBAHEN DHE LËSHOHEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25, pika 4, 57/6 deri në 57/10 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Modeli nr. 4 “Procesverbal për ndryshim emri/mbiemri”, në lidhjen nr. 1 që përmendet në shkronjën “ç” të pikës 1 të vendimit nr. 332, datë 17.3.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____
Zyra e Gjendjes Civile _____

PROÇESVERBAL Nr. _____

**“PËR MIRATIMIN E PASQYRIMIT TË NDRYSHIMIT TË EMRIT / MBIEMRIT TË
PRINDËRVE, PËR RASTET E PAPËRSHTATSHMËRISE”**

Sot më datë ____/____/____ në praninë time _____, nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile _____, u paraqit shtetasi _____ me numër personal _____, emri i babait _____, emri i nënës _____, i datëlindjes ____/____/____, vendlindja _____, banues në adresën _____

i cili, pranon të pasqyrojë ndryshimin e emrit /mbiemrit të babait/nënës, për shkakun se: me Vendim Nr.____, Datë ____ / ____ / ____ të Komisionit Kombëtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i është miratuar kërkesa për ndryshimin e emrit/mbiemrit si i papërshtatshëm _____.

Bazuar në Nenin 57/10, të Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar, të bëhet pasqyrimi i vendimit të Komisionit Kombëtar për ndryshimin e emrit/mbiemrit,

nga (_____) në (_____)
në të dhënat e pjestarëve madhorë të familjes, të cilët bien dakort për pasqyrimin e këtij ndryshimi në përbërësit e tyre të gjendjes civile dhe nënshkruajnë në këtë procesverbal.

Kërkuesi

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Personat madhorë të familjes

1. _____
3. _____
5. _____
7. _____
9. _____

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

2. _____
4. _____
6. _____
8. _____
10. _____

mod 4



VENDIM
Nr. 1008, datë 13.11.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË
PROKURIMIT, ME OBJEKT “MIRËMBAJTJE E SISTEMIT TË VËZHGIMIT TË
INTEGRUAR TË HAPËSIRËS DETARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të zhvillojë procedurën e prokurimit, me objekt “Mirëmbajtje e sistemit të vëzhgimit të integruar të hapësirës detare”, me fond limit 85 000 000 (tetëdhjetë e pesë milionë) lekë, pa TVSH.

2. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe drejtori i Agjencisë së Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 16 lekë